



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr.110, datë 27.06.2024

**PËR**

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN MANJOLA KAJANA”**

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Manjola Kajana, si eksperte ligjore në kuadër të Projektit “Global Firearms Programme”, të zbatuar nga organizata Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit të Organizuar (UNODC).
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe prokurori Manjola Kajana.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2024.

**KRYETAR**

Mirela Bogdani

